



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 7 prot.

Kamëz, më 24.1. 2025

V E N D I M
Nr. 7 .Datë 24 / 1 2025
MBI

“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR PËRDORIMIN E PRONËS PËR PËRCAKTIMIN E VENDGROPOSJES TË KAFSHËVE NË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 24.01.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.09 Datë 21.01.2025 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 10465, prot., datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 475, datë 30.07.2021 “Për bashkëpunimin e Njërive të Vetëqeverisjes Vendore me Shërbimin Veterinar”, Urdhërit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Kamëz me nr. 204, datë 17.01.2025 “Për ngritjen e grupit të punës mbi përcaktimin e vendgroposjes së kafshëve”, si dhe në kuadër të realizimit të detyrave funksionale sipas Shkresës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me nr. 8504 prot., datë 31.12.2024, “Kërkesë për bashkëpunim mbi përcaktimin e vendgroposjes të kafshëve”; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së pëlqimit në parim për përdorimin e pronës në Zonën Kadastrale 1066, Nr.pasurie 1444/5, Sipërfaqe 500 m² për vendgroposjen e kafshëve sipas planit të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për nxjerrjen e Urdhërit, për përcaktimin e vendgroposjes dhe procedurave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe Drejtoria e Kadastrës.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI

